



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:187954

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05757954

CAP.nr.1616/23

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Arsim Hamzaj, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit të përmbartimit F.M nga ,, , të cilin me autorizim e përfaqëson av.M.B nga P,,,,, kundër debitorit të përmbartimit Komuna e Novobërdës - Drejtoria Komunale e Arsimit në Novobërdë, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - dega në Novobërdë, CPK.Nr.09/23, të datës 22.09.2023, me datën **30.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit të përmbartimit Komuna e Novobërdës - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - dega në Novobërdë, CPK.Nr.09/23, i datës 22.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan - dega në Novobërdë, me aktvendimin CPK.Nr.09/23, të datës 22.09.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pa bazuar kundërshtimin e debitorit Drejtoria Komunale e Arsimit në Novobërdë, i datës 07.08.2023, i paraqitur kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.363/23 të datës 17.07.2023. Në pikën II të dispozitivit e ka lënë në fuqi Urdhrit Përmbartimor, P.nr.363/23 të datës 17.07.2023 dhe në pikën III të dispozitivit e ka obliguar debitorin - Komuna e Novobërdës që në emër të shpenzimeve të procedurës së përmbartimit ushtrimit të propozimit për përmbartim, të paguajë shumën prej 117.00€.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor debitori ka paraqitur ankesë pa i specifikuar bazat e ankesës, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e debitorit si të bazuar dhe të pezullohet përmbartimi i përcaktuar me urdhër ekzekutiv të përmbartuesit privat CPK-

09/23 i datës 17.07.2023 e cila ka refuzuar në tersi si të pa bazuar ankesën e debitorit dhe ka anuluar të gjitha veprimet përmbarimore të ekzekutuara.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori F.M nga ,, me datën 17.07.2023, ka paraqitur propozim për përmbarim, ndaj debitorit Drejtoria Komunale e Arsimit në Novobërdë, në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.Nr.590/20 i datës 25.03.2021. Përmbaruesi Privat ,, , i emëruar në territorin e Gjykatës Themelore në Pejë, ka nxjerrë Urdhrin Përmbarimorë P.Nr.363/23, me të cilin ka caktuar përmbarimin.

Kundër Urdhrit për caktimin e përmbarimit, debitori me datën 07.08.2023, ka paraqitur prapësim me të cilin ka kërkuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, duke propozuar që i njëjti të aktvendimi i atakuar të anulohet si i pa bazë, me arsyetim se nuk ka pasur kushte ligjore që gjykata të urdhërojë këtë përmbarim në kuptim të neneve 22 dhe 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Kreditori në afatin ligjor pas marrjes së kundërshtimit, ka paraqitur përgjigje në prapësim më dt.14.08.2023, duke theksuar se i kundërshton pretendimet e debitorit me arsyetimin se debitori nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e paraqitjes së prapësimit konform dispozitës së nenit 71 të LPP-së dhe se debitori me paraqitjen e këtij prapësimi, po mundohet vetëm ta zvarrit procedurën përmbarimore me qëllim që mos ta paguajë detyrimin e tij për borxhin që ka ndaj kreditorit. Aktvendimi mbi shpenzimet konsiderohet aktvendim i veçantë në vështrim të dispozitave ligjore të LPK-së.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar CPK.Nr.09/23, të datës 22.09.2023, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata ka theksuar se pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se prapësimi i debitorit i datës 07.08.2023, është i pabazuar, pasi që nuk është i mbështetur në asnjë nga shkaqet e Prapësimit sipas nenit 71 të LPP-së, sepse Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.590/20, i datës 25.03.2021 i plotfuqishëm me datën 20.03.2023, dhe i ekzekutueshëm me datë 14.04.2023, respektivisht dispozitivi i II-të, është dokument përmbarimorë - titull ekzekutiv sipas nenit 22 paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së në të cilin parashihet se dokumente përmbaruese janë “ *Vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese*”, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Për shpenzimet e procedurës përmbarimore gjykata e shkallës së parë vendosi si në bazë të nenit 13 par. 6 të LPP-së dhe nenit 452 të LPK-së dhe tarifave të OAK, dhe për përpilimin e propozimit për përmbarim shumë prej 117€.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruar nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur prapësimin e debitorit e ka refuzuar si të pabazuar duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të ankimuar. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.590/20, i datës 25.03.2021 i plotfuqishëm me datën 20.03.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 14.04.2023, në rastin konkret është dokument përmbarues, kjo parashihet në nenin sipas nenit 22 paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së dhe përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 dhe 27 paragrafi 1 të po këtij ligji ku përcaktohet se *“dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të LPP me rastin e refuzimit prapësimin, nuk qëndrojnë.

Në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktojë dhe zbatojë përmbarimin. Nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se nuk ka pasur kushte ligjore që gjykata ta refuzoj ankesën e debitorit në tersi, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata në procedurë përmbarimore i përmbahet parimit të rigorozitet formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbarimor, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për lejimin e përmbarimit dhe në procedurën sipas prapësimin gjykata e shkallës së parë i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP, me të cilën është paraparë se *“në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1616/23, me datën 30.05.2024

Gjyqtari
Arsim Hamzaj